

VENDIM
Nr.803, datë 12.12.2006

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE SLOVENE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.93763, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake slovene, të përbëra prej 36 (tridhjetë e gjashtë) trupash dhe 18 (tetëmbëdhjetë) mjetesh, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 13 dhjetor 2006.

Nga këto, 26 (njëzet e gjashtë) trupa, 1 (një) autobus dhe 2 (dy) makina të Policisë Ushtarake do të rikthehen në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit në Qafë-Thanë. Pikat e daljes do të jenë Porti i Durrësit dhe pika e kalimit të kufirit në Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Trupat slovene, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha